



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 28

Tiranë – E mërkurë, 12 shkurt 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 19.12.2024	Për licencat dhe autorizimet e lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes..... 3155
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 56, datë 4.2.2025	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë..... 3165
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 96, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë..... 3166
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 97, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës..... 3166
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 98, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.... 3169
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 99, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Lituanisë.... 3170
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 100, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 3171
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 101, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë..... 3172
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 102, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë..... 3173

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 103, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	3175
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 104, datë 31.1.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Norvegjisë.....	3177
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 10, datë 5.2.2025	Për disa ndryshime në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”	3178
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 11, datë 5.2.2025	Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”	3179
Vendim i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit nr. 3, datë 3.2.2025	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	3184
Vendim i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit nr. 4, datë 3.2.2025	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	3240



VENDIM

Nr. 793, datë 19.12.2024

PËR LICENCAT DHE AUTORIZIMET E LËSHUARA NGA AGJENCIA E INDUSTRIKË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 12, të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim të rregullojë procesin e licencimit dhe autorizimit të operatorëve ekonomikë për kryerjen e veprimtarive të prodhimit, magazinimit, transportimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake.

2. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i llojeve të licencave dhe autorizimeve, kritereve të detajuara, procedurave të lëshimit, rinovimit, pezullimit dhe revokimit të tyre si dhe i tarifave të aplikimit e të përdorimit të licencës dhe autorizimit.

3. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Asgjësimi”**, pjesë e procesit të demilitarizimit që synon eliminimin e armatimit ushtarak nëpërmjet shkatërrimit fizik, djegies, shpërthimit me eksploziv, shpërbërjes kimike dhe metodave të tjera të aprovuara.

b) **“Dyshimi i arsyeshëm”**, bindja e krijuar si rezultat i analizave dhe vlerësimeve të argumentuara mbi informacione të siguruar nga agjencitë ligjzbatuese dhe të inteligjencës për ekzistencën e një elementi të qenësishëm risku në funksion të procesit të licencimit.

c) **“Influenca e huaj”**, formë kontrolli apo ndikimi që i referohet një situatë në të cilën një palë e tretë e huaj (individ, operator ekonomik apo qeveri) vlerësohet që posedon ndikim apo autoritet mbi një operator ekonomik, në një shkallë të tillë që krijon mundësinë e ndikimit në vendimmarrje ose të përfitimit të aksesit në informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

ç) **“Magazinimi”**, procesi i administrimit të armatimit ushtarak gjatë prodhimit, zhvillimit dhe tregtimit në hapësira të caktuara që sigurojnë mbrojtjen fizike dhe ruajtjen e parametrave teknikë.

d) **“ML”**, kodi i cili i referohet listës së mallrave ushtarake, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me renditjen dhe përkufizimet e cituara në atë listë.

dh) **“Montimi”**, procesi i bashkimit të pjesëve përbërëse për krijimin e armatimit ushtarak.

e) **“Oficeri i sigurisë”**, punonjësi i stafit menaxherial të operatorit ekonomik përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të sigurisë së informacionit, personelit dhe çdo aspekti tjetër që lidhet me sigurinë, sipas legjislacionit në fuqi.

ë) **“Operatori ekonomik”**, subjekti aplikues, i cili kërkon të pajiset me licencën ose autorizimin përkatës për prodhimin, tregtimin, kërkimin dhe zhvillimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake.

f) **“Plani i vazhdimësisë së biznesit”**, dokumenti që përcakton veprimet që duhet të ndërmerren përpara, gjatë dhe pas ngjarjeve dhe situatave të papritura.

g) **“Projektimi”**, procesi i krijimit dhe zhvillimit të ideve, modeleve, hartimit të dokumentacionit dhe specifikimeve teknike për armatimin ushtarak.

gj) **“Riparimi”**, procesi i rikthimit të armatimit ushtarak në gjendje funksionale ose në gjendjen më optimale pas dëmtimit ose amortizimit, duke përfshirë diagnostikimin, zëvendësimin e pjesëve dhe testimin.

h) **“Transportimi”**, çdo lëvizje fizike e armatimit ushtarak brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë transportin tokësor, detar dhe ajror, përveç lëvizjeve brenda objektit të prodhimit/zhvillimit/tregtimit ose vendit të punës.

i) **“Vlerësimi i sigurisë”**, tërësia e masave dhe e procedurave të aplikuar ndaj një individi ose operatori ekonomik, më qëllim mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga institucionet përgjegjëse për të vlerësuar sigurinë e individit ose operatorit ekonomik, në raport me veprimtarinë që kërkojnë të kryejnë dhe vetëm në funksion të procesit të licencimit.

j) **“Vlerësimi i besueshmërisë”**, akti i organit përgjegjës të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ku dokumentohet procesi i vlerësimit të të dhënave të individit në raport me ato të regjistruara fizikë dhe elektronikë.



II. LICENCAT PËR PRODHIMIN E ARMATIMIT USHTARAK

1. Licencat e lëshuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes (në vijim “AIM”), në kuadër të veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak, përfshijnë:

a) Licencën paraprake për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit, e cila i njeh subjektit të licencuar të drejtën për zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe teknologjike të nevojshme për prodhimin e armatimit ushtarak;

b) Licencën për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit, e cila i njeh subjektit të licencuar të drejtën për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak.

2. Licencat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij kreu, lëshohen për:

- a) prodhim;
- b) projektim;
- c) montim;
- ç) riparim;
- d) demilitarizim.

3. Licencat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, sipas veprimtarive të përmendura në pikën 2 të këtij kreu jepen për një ose disa nga mallrat e mëposhtme:

- a) Armë (ML 1, ML 2);
- b) Municione (ML 3, ML 4);
- c) Mjete luftarake dhe mjete mbrojtëse (ML 6, ML 9, ML 10);
- ç) Sisteme dhe pajisje ushtarake (ML5, ML11, ML12, ML15, ML19);
- d) Pajisje për mbrojtje dhe mbështetje (ML7, ML13, ML14);
- dh) Materiale, komponentë dhe pajisje prodhimi (ML8, ML16, ML17, ML18);
- e) Teknologji të avancuara dhe *software* (ML20, ML21, ML22).

4. Operatori ekonomik gjatë aplikimit për licencën për kryerjen e veprimtarisë përcakton veprimtarinë sipas pikës 2 dhe mallin sipas pikës 3, të këtij kreu, si dhe kodin përkatës “ML”, për të cilin kërkon të ushtrojë veprimtarinë.

III. LICENCAT PËR TREGTIMIN, MAGAZINIMIN DHE TRANSPORTIN E ARMATIMIT USHTARAK

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, në kuadër të veprimtarisë së tregtimit, magazinimit dhe transportimit të armatimit ushtarak, lëshon:

a) Licencën për tregtimin e armatimit ushtarak, e cila i njeh subjektit të licencuar të drejtën për kryerjen e veprimtarisë ekonomike që, nëpërmjet proceseve të shitjes dhe blerjes, synon të transferojë armatimin ushtarak nga prodhuesi tek përdoruesi fundor, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësve, brenda dhe jashtë vendit;

b) Licencën për magazinimin e armatimit ushtarak, e cila i njeh subjektit të licencuar të drejtën për administrimin e armatimit ushtarak gjatë prodhimit, zhvillimit dhe tregtimit;

c) Licencën për transportimin e armatimit ushtarak, që i njeh subjektit të licencuar të drejtën për të kryer çdo lëvizje fizike të armatimit ushtarak brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Licencat e përmendura në pikën 1 të këtij kreu lëshohen për një ose disa nga mallrat e mëposhtme:

- a) Armë (ML 1; dhe/ose ML 2);
- b) Municione (ML 3; dhe/ose ML 4);
- c) Mjete luftarake dhe mjete mbrojtëse (ML 6; dhe/ose ML 9; dhe/ose ML 10);
- ç) Sisteme dhe pajisje ushtarake (ML5: ML11: ML12: ML15: ML19);
- d) Pajisje për mbrojtje dhe mbështetje (ML7: ML13: ML14);
- dh) Materiale, komponentë dhe pajisje prodhimi (ML8: ML16: ML17: ML18);
- e) Teknologji të avancuara dhe *software* (ML20: ML21: ML22).

3. Operatori ekonomik gjatë aplikimit për licencë duhet të specifikojë veprimtarinë sipas pikës 1 dhe mallin sipas pikës 2 të këtij kreu, si dhe kodin përkatës “ML”, për të cilin kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë.

IV. LLOJET E AUTORIZIMEVE

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, në kuadër të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik të armatimit ushtarak, i njeh subjektit të autorizuar të drejtën për të ndërmarrë procese novatore për zhvillimin e produkteve të reja ose përmirësimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve ekzistuese, duke lëshuar:

a) “Autorizim për kërkim dhe zhvillim teknologjik bazë”. Ky autorizim jepet për procese të lidhura me zhvillimin në nivel teorik të kërkimit ose që nuk synojnë aplikimin praktik;

b) “Autorizim për kërkim dhe zhvillim teknologjik i aplikuar”. Ky autorizim jepet për procese që synojnë zgjidhjen konkrete të një problematike;



c) “Autorizim për kërkim dhe zhvillim teknologjik eksperimental”. Ky autorizim jepet për procese që përfshijnë krijimin e një prototipi.

2. Autorizimet e përmendura në pikën 1 të këtij kreu, lëshohen për një ose disa nga mallrat e mëposhtme:

a) Armë (ML 1; dhe/ose ML 2);

b) Municione (ML 3; dhe/ose ML 4);

c) Mjete luftarake dhe mjete mbrojtëse (ML 6; dhe/ose ML 9; dhe/ose ML 10);

ç) Sisteme dhe pajisje ushtarake (ML5: ML11: ML12: ML15: ML19);

d) Pajisje për mbrojtje dhe mbështetje (ML7: ML13: ML14);

dh) Materiale, komponentë dhe pajisje prodhimi (ML8: ML16: ML17: ML18);

e) Teknologji të avancuara dhe *software* (ML20: ML21: ML22).

3. Operatori ekonomik gjatë aplikimit për autorizim duhet të specifikojë llojin e autorizimit sipas pikës 1 dhe mallin sipas pikës 2 të këtij kreu, si dhe kodin përkatës “ML”, për të cilin kërkon të autorizohet.

V. KRITERET E DHËNIES SË LICENCE DHE AUTORIZIMIT

1. Operatori ekonomik, që aplikon për një nga licencat e përcaktuara në kërret II dhe III të këtij vendimi, duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme ligjore dhe të sigurisë:

a) Të jetë i regjistruar si subjekt në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e biznesit;

b) Të ketë objekt veprimtarie në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkon të licencohet;

c) Operatori ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për krime të rënda, krime të organizuara dhe krime me qëllime terroriste, sulme kibernetike, trafikim ndërkombëtar të armatimit ushtarak, si dhe të mos ketë qenë subjekt i masave shtrënguese ndërkombëtare;

ç) Të ketë plan biznesi dhe plan të fizibilitetit ekonomik;

d) Të ketë kaluar pozitivisht vlerësimin e sigurisë për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse,

administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë të operatorit ekonomik;

dh) Të ketë kaluar pozitivisht vlerësimin e besueshmërisë për personelin e angazhuar në veprimtarinë e operatorit ekonomik, të cilët nuk përfshihen në kategoritë e përmendura në shkronjën “d”, të kësaj pike.

2. Operatorit ekonomik i jepen licencat në kuadër të veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak, të përcaktuara në pikën 1, të kreut II, në rastet kur, përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, plotëson këto kritere specifike:

a) Kriterin financiar: të ketë një kapital të vazhdueshëm në përputhje me planin e biznesit.

b) Kriterin teknik dhe operacional:

i. të zotërojë kapacitetet e nevojshme teknike, përfshirë përvojën, infrastrukturën, teknologjinë dhe burimet njerëzore për prodhimin e armatimit ushtarak që synon të prodhojë;

ii. të demonstrojë përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të OKB-së, NATO-s, BE-së ose standardeve shqiptare të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, për prodhimin dhe produktin;

iii. të demonstrojë aftësinë për menaxhimin e riskut për secilin nga proceset e punës;

iv. të ketë kapacitetet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri dhe nga shpëtimi në rast zjarri dhe të ngjarjeve të jashtëzakonshme;

v. të demonstrojë marrjen e masave për ruajtjen fizike të zonës së prodhimit dhe magazinimit të lëndëve të para dhe produktit të gatshëm;

vi. të ketë planin e vazhdimësisë së biznesit.

c) Kriterin e sigurisë: të demonstrojë marrjen e masave për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të sigurisë së informacionit, të personelit dhe çdo të aspekti tjetër që lidhet me sigurinë, sipas legjislacionit në fuqi.

ç) Kriterin mjedisor: t’u nënshtrohet procedurave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe marrjes së licence përkatëse mjedisore në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

3. Operatorit ekonomik i jepet licenca e tregtimit të armatimit ushtarak, në rastet kur përveç kritereve të përgjithshme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, plotëson kriterin specifik mbi disponueshmërinë e planit të vazhdimësisë së biznesit.



4. Operatorit ekonomik i jepet licenca e magazinimit të armatimit ushtarak, në rastet kur përveç kriterëve të përgjithshme të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu plotëson këto kriterë specifike:

- a) Të ketë planin e vazhdimësisë së biznesit;
- b) Të zotërojë kapacitetet e nevojshme teknike, përfshirë infrastrukturën dhe burimet njerëzore për magazinimin e armatimit ushtarak;
- c) Të demonstrojë përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të OKB-së, NATO-s, BE-së ose standardeve shqiptare të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, për magazinimin e armatimit ushtarak;
- ç) Të demonstrojë aftësinë për menaxhimin e riskut për secilin nga proceset e punës;
- d) Të demonstrojë përmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi për eliminimin e rrezikut të zjarrit, shpërthimit, vjedhjes, humbjes dhe pasojave të krijuara nga këto ngjarje;
- dh) T'u nënshtrohet procedurave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe marrjes së licencave përkatëse mjedisore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

5. Operatorit ekonomik i jepet licenca e transportimit të armatimit ushtarak, në rastet kur, përveç kriterëve të përgjithshme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, plotëson këto kriterë specifike:

- a) Të ketë planin e vazhdimësisë së biznesit;
- b) Të zotërojë kapacitetet e nevojshme teknike, përfshirë mjetet dhe burimet njerëzore për transportin e armatimit ushtarak;
- c) Të demonstrojë përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të OKB-së, NATO-s, BE-së ose standardeve shqiptare të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, për transportin e armatimit ushtarak;
- ç) Të demonstrojë aftësinë për menaxhimin e riskut për secilin nga proceset e punës;
- d) Të demonstrojë përmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi për eliminimin e rrezikut të zjarrit, shpërthimit, vjedhjes, humbjes dhe pasojave të krijuara nga këto ngjarje.

6. Operatorit ekonomik i jepet autorizimi për kërkimin dhe zhvillimin teknologjik, në rastet kur plotëson këto kriterë:

- a) Të jetë i regjistruar si subjekt në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e biznesit;

b) Të jenë plotësuar kushtet e verifikimit të sigurisë për ortakët, aksionarët, administratorët, drejtorët dhe menaxherët e lartë të operatorit ekonomik;

c) Të jenë plotësuar kushtet e verifikimit të besueshmërisë për personelin e angazhuar në veprimtarinë e operatorit ekonomik, të cilët nuk përfshihen në kategoritë e sipërpërmendura;

ç) Të plotësojë standardet kërkimore që lidhen me integritetin dhe përgjegjësinë gjatë kryerjes së kërkimeve e të eksperimenteve.

VI. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

1. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e licencës paraprake për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak vlerësohet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

- a) Ekstrakti historik;
- b) Lista e ortakëve, bordit drejtues, stafit menaxherial dhe administrativ të shoqërisë. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;
- c) Struktura organizative e shoqërisë;
- ç) Dëshmia e penalitetit për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë;
- d) Vërtetimi nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;
- dh) Vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;
- e) Vërtetimi nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;
- ë) Vërtetimi mbi kapacitetet financiare;
- f) Plani i biznesit;
- g) Plani i vazhdimësisë së biznesit;
- gj) Projekti dhe plan-vendosja e strukturës ku do të zhvillohet prodhimi dhe magazinimi, duke përcaktuar kapacitetet prodhuese dhe magazinuese;
- h) Projekti teknologjik i prodhimit, i detajuar për çdo lloj të armatimit ushtarak që kërkohet të prodhohet, së bashku me listën e makinerive që do të përdoren, lëndët e para të nevojshme për çdo produkt, si dhe specifikimet teknike përkatëse;
- i) Projekti teknik i zbatimit të linjës/linjave të prodhimit që përfshin:
 - i. planimetritë e objekteve (projekti i ndërtimit) të prodhimit dhe magazinimit të lëndëve të para dhe produktit të gatshëm, të rrejtut të furnizimit me



energji, ujë, ajër dhe lëndë të tjera ndihmese, të sistemit të ventilimit;

ii. rrjetin e kanalizimeve dhe shkarkimeve teknologjike, sistemin e mbrojtjes nga zjarri dhe shkarkimet atmosferike;

iii. plan-vendosjen e objekteve të linjës/linjave të prodhimit, kapacitetet e prodhimit dhe të magazinimit për çdo objekt dhe linjë, plan-vendosjen e makinerive dhe pajisjeve për çdo objekt, skemën teknologjike të lëvizjes së materialeve në objekt dhe në linjë, si dhe rrugët e lëvizjes për mjetet dhe personelin;

iv. plan-vendosjen e objekteve të linjës/linjave të prodhimit dhe magazinimit, reparteve ndihmëse, objekteve të personelit dhe zyrave të administratës, sasi të e lejuara të lëndëve të para, armatimit dhe lëndëve eksplozive për çdo objekt, linjë dhe për gjithë zonën ku është vendosur aktiviteti i prodhimit, numrin e personelit të lejuar për çdo objekt, linjë dhe për gjithë aktivitetin e prodhimit;

v. distancat e sigurisë midis objekteve të prodhimit dhe magazinimit, objekteve të qëndrimit të punonjësve dhe administratës, si dhe nga zonat e banuara dhe rrugët e lëvizjes jashtë zonës ku zhvillohet aktiviteti;

vi. skemën e lëvizjes së personelit dhe vendqëndrimin në rast ngjarjeje për personelin, administratën dhe vizitorët;

j) Projekti për trajtimin e mbetjeve të prodhimit, duke përcaktuar mënyrën e administrimit, ruajtjes dhe asgjësimit përfundimtar;

k) Plani dhe projekti përkatës i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;

l) Marrëveshja e lidhur me një organizëm vendës apo të huaj, i cili do të bëjë certifikimin e produktit dhe linjës teknologjike sipas standardeve ndërkombëtare të OKB-së, NATO-s, BE-së ose standardeve shqiptare të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për prodhimin dhe produktin;

ll) Projekti/skica, të dhënat teknike të produktit, të cilat kërkohen të prodhohen duke bërë referencë në standardin ndërkombëtar ose vendës që i referohet;

m) Grafiku i punimeve për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për procesin e prodhimit;

n) Plani i punësimit të personelit dhe trajnimit, duke përcaktuar pozicionet e veçanta si inxhinierë me përvojë ose të trajnuar në prodhimin e armatimit

ushtarak, si dhe teknikë e menaxherë të prodhimit me përvojë ose të trajnuar në industrinë e mbrojtjes;

nj) Aplikimi për sigurimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe për lejet përkatëse mjedisore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe atij për lejet e mjedisit.

2. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e licencës së kryerjes së veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak vlerësohet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) Ekstrakti historik;

b) Lista e ortakëve, bordit drejtues, stafit menaxherial dhe administrativ të shoqërisë. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

c) Struktura organizative e shoqërisë;

ç) Dëshmia e penalitetit për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë;

d) Vërtetimi nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

dh) Vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

e) Vërtetimi nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;

ë) Vërtetimi mbi kapacitetet financiare;

f) Plani i biznesit;

g) Plani i vazhdimësisë së biznesit;

gj) Akti i kolaudimit të objektit, të makinerive si dhe të linjës teknologjike të prodhimit, i shoqëruar me dosjen ku të përcaktohen:

i. planimetritë e objekteve (projekti i ndërtimit) të prodhimit dhe magazinimit të lëndëve të para dhe produktit të gatshëm, të rrjetit të furnizimit me energji, ujë, ajër dhe lëndë të tjera ndihmëse, të sistemit të ventilimit;

ii. rrjeti i kanalizimeve dhe shkarkimeve teknologjike, sistemi i mbrojtjes nga zjarri dhe shkarkimet atmosferike;

iii. vendosja e objekteve të linjës/linjave të prodhimit, kapacitetet e prodhimit dhe të magazinimit për çdo objekt dhe linjë, vendosja e makinerive dhe pajisjeve për çdo objekt, skema teknologjike e lëvizjes së materialeve në objekt dhe në linjë, si dhe rrugët e lëvizjes për mjetet dhe personelin;



iv. vendosja objekteve të linjës/linjave të prodhimit dhe magazinimit, reparteve ndihmëse, objekteve të personelit dhe zyrave të administratës, sasive të lejuara të lëndëve të para, armatimit dhe lëndëve eksplozive për çdo objekt, linjë dhe për gjithë zonën ku është vendosur aktiviteti i prodhimit, numrit të personelit të lejuar për çdo objekt, linjë dhe për gjithë aktivitetin e prodhimit;

v. distancat e sigurisë midis objekteve të prodhimit dhe magazinimit, objekteve të qëndrimit të punonjësve dhe administratës, si dhe nga zonat e banuara dhe rrugët e lëvizjes jashtë zonës ku zhvillohet aktiviteti;

vi. skema e lëvizjes së personelit dhe vendqëndrimi në rast ngjarjeje për personelin, administratën dhe vizitorët;

h) Mënyra e caktuar e trajtimit, administrimit, ruajtjes dhe asgjësimit përfundimtar të mbetjeve të prodhimit;

i) Certifikatat e produktit të lëshuara nga një organizëm vendës apo i huaj, i cili ka kryer certifikimin e produktit dhe linjës teknologjike sipas standardeve ndërkombëtare të OKB-së, NATO-s, BE-së ose standardeve shqiptare, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi, për prodhimin dhe produktin;

j) Kontrata e punës me drejtuesin teknik, i cili është përgjegjës për prodhimin, çështjet e sigurimit teknik, trajnimit të personelit me rregullat e sigurimit teknik;

k) Certifikata e trajnimit nga drejtuesi teknik dhe leja e përdorimit të pajisjeve për të gjithë operatorët që marrin pjesë në procesin e prodhimit dhe mirëmbajtjes;

l) Dokumentacioni që vërteton ngritjen e sistemit të gjurmimit dhe markimit;

ll) Rregullorja e miratuar e sigurimit teknik, mbrojtjes nga zjarri, hartuar nga drejtuesi teknik, ku përcaktohen kushtet e sigurisë, trajnimi i punonjësve, masat për sigurimin e jetës, shëndetit të punonjësve dhe mjedisit, masat parandaluese dhe mbrojtëse, si dhe menaxhimin e emergjencave gjatë proceseve të punës, sipas standardeve ndërkombëtare të OKB-së, NATO-s, BE-së ose standardeve shqiptare të miratuara sipas legjislacionit në fuqi;

m) Akti teknik i miratuar nga institucioni përgjegjës, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes së zjarrit brenda dhe jashtë ambienteve të prodhimit e të magazinimit;

n) Kontrata e punës me oficerin e sigurisë, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e kërkesave të sigurisë së informacionit, personelit dhe çdo aspekt tjetër që lidhet me sigurinë, sipas legjislacionit në fuqi;

nj) Rregullorja për infrastrukturën digjitale dhe sigurinë kibernetike, ku të jenë përcaktuar procedurat e operimit, masat parandaluese dhe mbrojtëse ndaj kërcënimeve kibernetike;

o) Kontrata me një subjekt që ofron shërbimin e sigurisë fizike për ruajtjen dhe shoqërimin gjatë prodhimit të armatimit ushtarak;

p) Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe për lejet përkatëse mjedisore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe atij për lejet e mjedisit.

3. Në rastin kur një subjekt i pajisur me licencë paraprake për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak, aplikon për licencë për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit, AIM-ja nuk rivlerëson dokumentet e përcaktuara nga shkronja “a” deri në shkronjën “g”, të pikës 2, të këtij kreu, përveç rasteve kur ka ndryshim të informacionit të paraqitur me këto dokumente.

4. Gjatë shqyrtimit të aplikimit për licencë për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit për projektim të armatimit ushtarak, nuk vlerësohen dokumentet e përcaktuara nga shkronja “g” deri në shkronjën “k”, të pikës 2, të këtij kreu.

5. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e licencës së tregtimit të armatimit ushtarak vlerësohet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) Ekstrakti historik;

b) Lista e ortakëve, bordit drejtues, stafit menaxherial dhe administrativ të shoqërisë. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

c) Struktura organizative e shoqërisë;

ç) Dëshmia e penalitetit për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë;

d) Vërtetimi nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

dh) Vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

e) Vërtetimi nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;



ë) Vërtetimi mbi kapacitetet financiare;

f) Plani i biznesit;

g) Plani i vazhdimësisë të biznesit.

6. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e licencës së magazinimit të armatimit ushtarak vlerësohet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) Ekstrakti historik;

b) Lista e ortakëve, bordit drejtues, stafit menaxherial dhe administrativ të shoqërisë. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

c) Lista e personelit përgjegjës për magazinimin. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

ç) Dëshmia e penalitetit për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë;

d) Vërtetimi nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

dh) Vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

e) Plani i biznesit;

ë) Plani i vazhdimësisë të biznesit;

f) Dokumenti i pronësisë apo përdorimit të objektit për magazinim;

g) Projekti i ndërtimit për magazinën, ku të jenë përcaktuar:

i. plan-vendosja e zonës ku do të bëhet magazinimi, plan-vendosjen e objektit/objekteve ku do të magazinohen produktet dhe ambientet për personelin, projekti i ndërtimit të objektit, planimetria e rrugëve të lëvizjes për produktet dhe personelin, barrierave mbrojtëse dhe sistemeve për mbrojtjen nga zjarri dhe shkarkimet atmosferike, projekti për rrethimin zonës me mure mbrojtëse, ndriçimit të jashtëm dhe monitorimit me kamera;

ii. lloji dhe sasia e produkteve që do të magazinohen, peshat neto të lëndëve plasëse (NEW ose NEQ) të lejuara, klasat dhe kategoritë e municioneve, të agjentëve kimikë ose të materialeve të tjera të rrezikshme që vendosen në ambientet e magazinimit;

iii. distancat e sigurisë së objekteve brenda zonës, si dhe nga zonat e banuara, rrugët nacionale, hekurudhat dhe zonat e mbrojtura, limitet e lejuara për personelin për çdo objekt dhe për zonën;

gj) Akti i kolaudimit të lëshuar nga një organizëm vendës apo i huaj, i cili ka kryer kolaudimin e magazinës sipas standardeve ndërkombëtare të OKB-së, NATO-s, BE-së për magazinimin e armatimit ushtarak ose standardeve shqiptare, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me projektin e magazinës;

h) Kontrata me një subjekt që ofron shërbimin e sigurisë fizike për ruajtjen e magazinës;

i) Rregullorja e sigurimit teknik, ku përcaktohen kushtet e sigurisë, trajnimi i punonjësve, masat për sigurimin e jetës, shëndetit të punonjësve dhe mjedisit, masat parandaluese dhe mbrojtëse për eliminimin e rrezikut të shpërthimit, vjedhjes apo humbjes, si dhe menaxhimin e emergjencave gjatë ngjarjeve aksidentale ose të padëshirueshme;

j) Akti teknik i miratuar nga institucioni përgjegjës, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes nga zjarri si brenda dhe jashtë ambienteve të magazinimit;

k) Perimetri i jashtëm të jetë i monitoruar me sistem të kamerave CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe, që ruajnë imazhet filmike në NRV/server, minimalisht deri në 2 muaj.

7. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e licencës së transportit të armatimit ushtarak vlerësohet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) Ekstrakti historik;

b) Lista e ortakëve, bordit drejtues, stafit menaxherial dhe administrativ të shoqërisë. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

c) Lista e personelit përgjegjës për transportin. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

ç) Dëshmia e penalitetit për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë;

d) Vërtetimi nga prokuroria, që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

dh) Vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

e) Vërtetimi nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;

ë) Plani i biznesit;

f) Plani i vazhdimësisë të biznesit;



g) Certifikata e miratimit të mjetit, sipas ADR-së, e lëshuar nga institucionet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme, që vërteton se një mjet i vetëm i destinuar për transportin e disa mallrave të rrezikshme plotëson kërkesat teknike përkatëse, për rastet e transportit të lëndëve plasëse dhe të municioneve;

gj) Certifikata e vlefshme e trajnimit të drejtuesit të mjetit ADR për rastet e transportit të lëndëve plasëse dhe municioneve;

h) Dokumentacioni që provon pajisjen e automjetit me GPS-in funksional për kontrollin dhe dokumentimin e itinerarit në subjektin që bën transportin;

i) Rregullorja e sigurimit teknik, ku përcaktohen kushtet e sigurisë, trajnimi i punonjësve, masat për sigurimin e jetës, shëndetit të punonjësve dhe mjedisit, masat parandaluese dhe mbrojtëse për eliminimin e rrezikut të shpërthimit, vjedhjes apo humbjes, si dhe menaxhimin e emergjencave gjatë ngjarjeve aksidentale ose të padëshirueshme;

j) Kontrata me një subjekt që ofron shërbimin e sigurisë fizike për ruajtjen dhe shoqërimin gjatë transportit të armatimit ushtarak.

8. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e autorizimit të kërkimit dhe zhvillimit bazë të armatimit ushtarak vlerësohet dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) Ekstrakti historik;

b) Lista e ortakëve, bordit drejtues, stafit menaxherial dhe administrativ të shoqërisë. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

c) Lista e personelit përgjegjës për transportin. Në rastin e shtetasve joshqiptarë, lista shoqërohet me kopjet e dokumentit identifikues;

ç) Dëshmia e penalitetit për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë;

d) Vërtetimi nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

dh) Vërtetimi që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë.

9. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e autorizimit të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik të aplikuar, përveç dokumentacionit të

përcaktuar në pikën 8 të këtij kreu do të vlerësohet edhe studimi i fizibilitetit të zgjidhjes së propozuar.

10. Për të verifikuar plotësimin e kriterëve për dhënien e autorizimit të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik eksperimental vlerësohet dokumentacioni i përcaktuar në pikën 8 të këtij kreu, si edhe:

a) studimi i fizibilitetit;

b) projekti/skica, të dhënat teknike të prototipit, të cilat kërkon të eksperimentojë duke bërë referencë në standardin ndërkombëtar ose vendës që i referohet;

c) plani i sigurisë për ruajtjen e teknologjisë dhe prototipit të cilin kërkon të eksperimentojë.

VII. PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN, REFUZIMIN, PEZULLIMIN, REVOKIMIN DHE RINOVIMIN E LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE

1. Operatori ekonomik, i cili kërkon të pajiset me licencë apo autorizim, duhet të paraqesë formularin e kërkesës, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara në këtë formular dhe të miratuara nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i subjektit, dhe dokumentacionin shoqërues, nëpërmjet platformës “e-Albania”.

2. Nga dokumentacioni i parashikuar në kreun VI, AIM-ja, me autorizimin e aplikuesit siguron brenda 10 (dhjetë) ditësh, nëpërmjet ndërveprimit institucional dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin historik;

b) Dëshminë e penalitetit për operatorin ekonomik, ortakët, organet drejtuese, aksionarët zotërues të kuotave vendimmarrëse, administratorët, përfaqësuesit, drejtuesit teknikë dhe menaxherët e lartë;

c) Vërtetimin nga prokuroria që shoqëria dhe administratori nuk janë në procedim penal;

ç) Vërtetimin që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

d) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve;

dh) Aktin teknik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për mjediset ku do të magazinohet dhe do të prodhohet.

3. Në rast se konstatohet se dosja e aplikimit nuk është e plotë, operatorit ekonomik i kërkohet plotësimi i saj me dokumentacionin e duhur. Operatori ekonomik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi, duhet të plotësojë mangësitë e evidentuara.



4. AIM-ja verifikon përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në kreun V, duke vlerësuar dokumentacionin e përcaktuar në kreun VI të këtij vendimi.

5. Me qëllim verifikimit të kriterit të sigurisë, me autorizim të aplikuesit, AIM-ja u kërkon organeve përkatëse ligjzbatuese dhe të inteligjencës informacion të vërtetuar mbi angazhimin e mundshëm në aktivitete të lidhura me cenimin e sigurisë kombëtare, terrorizmin, trafikun e armëve dhe narkotikëve, krimin e organizuar, shkeljen e sanksioneve ndërkombëtare, sulmet kibernetike, pastrim parash ose financim të terrorizmit.

6. AIM-ja, pas kryerjes së vlerësimit të sigurisë, kur ka dyshime të arsyetuara, kërkon nga operatori ekonomik të dhëna shtesë mbi palët e përfshira në veprimtarinë e licencuar/autorizuar nga kompanitë vendëse ose të huaja (ortakë, administrator, përfaqësues ligjor).

7. Me qëllim verifikimit të përmbushjes së kriterit të sigurisë lidhur me influencën e huaj, AIM-ja konsideron se është nën potencialin e mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja:

a) Çdo operator ekonomik vendës, i cili ka në përbërje mbi 5% të strukturës së pronësisë në zotërim të individëve, të cilët kanë shtetësinë e vendeve që nuk janë anëtare të NATO-s, BE-së apo të një shteti me të cilin vendi ynë akoma nuk ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit ushtarak dhe të sigurisë;

b) Çdo operator ekonomik vendës, i cili ka në pozitën e administratorit, anëtarit të stafit menaxherial apo të pozitave kyçe të drejtimit dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë së tij, individë të cilët kanë shtetësinë e vendeve që nuk janë anëtare të NATO-s, BE-së apo të një shteti me të cilin vendi ynë akoma nuk ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit ushtarak dhe të sigurisë.

8. Në rastet kur AIM-ja, pas verifikimit të brendshëm, sipas procedurës së verifikimit të sigurisë, vlerëson se operatori ekonomik është nën potencialin e mundshëm të influencës së ushtruar për llogari të interesave të huaja, përgatit një raport me të gjitha gjetjet dhe e dërgon për vlerësim pranë Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

9. Me qëllim verifikimit të përmbushjes së kriterëve teknike dhe operacionale, para lëshimit të licencës së prodhimit, AIM-ja kryen inspektime në vendin e prodhimit.

10. Në rastet kur operatori ekonomik disponon një certifikatë të sigurisë industriale, të miratuar sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë industriale dhe me një afat jo më pak se 3 (tre) vjet, nuk i nënshtrohet kriterit të verifikimit të sigurisë.

11. Operatori ekonomik, aksionar i të cilit është kompania shtetërore e prodhimit të armatimit ushtarak, nuk i nënshtrohet verifikimit të kriterit financiar dhe kriterit për ndikimin e influencës së huaj dhe të dokumenteve që verifikojnë këto kriterë.

12. Entet publike, të cilat kanë si fushë të përgjegjësisë së tyre sigurinë dhe mbrojtjen, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, përjashtohen nga pajisja me autorizim për kërkim dhe zhvillim teknologjik.

13. Në rastet kur operatori ekonomik disponon një licencë prodhimi të lëshuar në një nga vendet e BE-së ose vendet e NATO-s, me një afat vlefshmërie jo më pak se 3 (tre) vjet, kjo licencë njihet nga AIM-ja, e cila bën ekuivalentimin e saj duke reduktuar dokumentet dhe kohën e nevojshme për pajisjen me licencë. Për ekuivalentimin verifikohet që licenca e huaj përfshin kategoritë e armatimit ushtarak për të cilin kërkon të licencohet në vend.

14. Në përfundim të procesit të verifikimit të kriterëve dhe vlerësimit të dokumentacionit, operatorit ekonomik i lëshohet ose i refuzohet licenca apo autorizimi.

15. Në rastet e refuzimit të dhënies së licencës apo autorizimit, operatorit ekonomik i njoftohet vendimmarrja e arsyetuar.

16. Operatori ekonomik në rast ndryshimi të informacionit të paraqitur në dosjen e aplikimit njofton, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, AIM-në. Ndryshimet e njoftuara duhet të verifikohen dhe të miratohen nga AIM-ja brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

17. Në rastin e nënkontraktimit të një pjesë të aktivitetit nga subjekti i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit paraqet kërkesën pranë AIM-së. Kërkesa shoqërohet me arsyetimin dhe aktivitetin që kërkon të nënkontrakttojë. AIM-ja kryen verifikimet mbi kriterin e sigurisë për operatorin e ekonomik që do të nënkontrakttohet dhe, si rezultat i këtyre verifikimeve miraton ose refuzon autorizimin për nënkontraktim brenda 20 (njëzet) ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.



18. Në rastet kur konstatohet se subjekti i licencuar ose i autorizuar është në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 13, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, AIM-ja pezullon licencën apo autorizimin e lëshuar.

19. Raporti negativ i ndikimit në mjedis konsiderohet mospërmbushje e kushteve të licencës sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

20. Pas marrjes së njoftimit për pezullimin e licencës, subjekti duhet të korrigjojë rrethanën pezulluese, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve. AIM-ja, me qëllim verifikimin e korrigjimit, mund të kryejë inspekte në vend.

21. Në rastet kur konstatohet se subjekti i licencuar ose i autorizuar është në kushtet e parashikuara në pikën 5, të nenit 13, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, AIM-ja revokon licencën apo autorizimin e lëshuar.

22. Pas marrjes së njoftimit për revokimin e licencës, subjekti duhet të ndalojë aktivitetin.

23. Operatori ekonomik, 90 (nëntëdhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës apo autorizimit, paraqet kërkesën për rinovim. Rinovimi i licencës u nënshtrohet të njëjtave procedura të marrjes së licencës.

24. Operatori ekonomik ka të drejtën e ankimit administrativ, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”.

VIII. AFATET E APLIKIMIT, VLEFSHMËRISË DHE TARIFAT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE

1. Afati për shqyrtimin e aplikimit është, si më poshtë vijon:

a) 45 (dyzet e pesë) ditë nga dita e paraqitjes së dosjes së plotë të aplikimit për pajisjen me licencë paraprake për zhvillimin e veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak;

b) 90 (nëntëdhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së dosjes së plotë të aplikimit për pajisjen me licencë

për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak;

c) 30 (tridhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së dosjes së plotë të aplikimit për pajisjen me licencë për tregtimin, magazinimin e transportimin e armatimit ushtarak;

ç) 30 (tridhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së dosjes së plotë të aplikimit për pajisjen me autorizim për kërkim dhe zhvillim teknologjik.

2. Afatet e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu mund të zgjaten deri në 20 (njëzet) ditë, në rast se informacioni që do të përpunohet gjatë procesit të verifikimit të sigurisë përfshin individë apo subjekte të huaja.

3. Afati i vlefshmërisë së licencave dhe autorizimeve është, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) vjet për licencën paraprake të zhvillimit të veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak;

b) 10 (dhjetë) vjet për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të armatimit ushtarak;

c) 5 (pesë) vjet për licencën tregtimit, magazinimit dhe transportimit të armatimit ushtarak;

ç) 3 (tre) vjet për autorizimin për kërkim dhe zhvillim teknologjik për armatimin ushtarak.

4. Tarifa e aplikimit për pajisjen me licencë dhe autorizim, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

5. Tarifa vjetore e licencës është:

a) 1 000 000 (një milion) lekë për licencën për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit, montimit, demilitarizimit të armatimit ushtarak;

b) 200 000 (dyqind mijë) lekë për licencën për tregtimin, magazinimin, transportimin, projektimin, riparimin e armatimit ushtarak;

c) 100 000 (njëqind mijë) lekë për autorizimin e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik për armatimin ushtarak.

6. Për operatorin ekonomik, aksionar i të cilit është shoqëria shtetërore e prodhimit të armatimit ushtarak:

a) tarifa vjetore e licencës nuk zbatohet;

b) afati i licencave dhe autorizimeve është sa vlefshmëria e marrëveshjes së bashkëpunimit apo partneritetit.

7. Në rastet kur operatori ekonomik aplikon për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit, prodhimi, proceset e riparimit, projektimit, montimit dhe demilitarizimit që i nevojiten zhvillimit të aktivitetit



të prodhimit nuk konsiderohen si procese të ndara dhe nuk aplikohet tarifa përkatëse.

8. Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e përcaktuara në këtë krye derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në momentin e ngritjes së infrastrukturës së nevojshme për ofrimin e shërbimit nëpërmjet platformës “e-Albania”, aplikimet për pajisjen me licencë dhe autorizim do të paraqiten nëpërmjet shërbimit postar.

2. Ngarkohet Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 56, datë 4.2.2025

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PUBLIK, GJIMNAZI “SHABAN DEMIRAJ”, VLORE

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 1, të nenit 41, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 4, të kreut I/B, të vendimit nr. 662, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve parauniversitare publike” të ndryshuar, dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë.

2. Institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë, ka për detyrë:

a) të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

b) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë;

b) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar publik;

c) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Vlorë–Himarë për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Vlorë–Himarë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vlorë–Himarë dhe institucioni arsimor parauniversitar publik, Gjimnazi “Shaban Demiraj”, Vlorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani



URDHËR
Nr. 96, datë 31.1.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E ITALISË**

“1/1. Përfshirje nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni bën kategoria e kredisë konsumatore me këste, në intervalin e shumave të disbursuara 0-200.000 lekë (ose ekuivalenti në monedhat e huaja), për të cilën Banka e Shqipërisë përvakton normën efektive maksimale të interesit sa mesatarja e thjeshtë e normës efektive të interesit për kredinë konsumatore me këste në intervalin e lartpërmendur.”;

e) Pas nenit 15, shtohet neni 15/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Neni 15/1

Kërkesa për komisionet në kontratat e kredisë konsumatore

Për kontratat e kredisë konsumatore, komisionet që lidhen me aplikimin për kredi, procesimin, administrimin, miratimin dhe disbursimin e kredisë, paguhet nga konsumatori në momentin e disbursimit të kredisë dhe nuk shpërndahet gjatë jetëgjatësisë së kredisë.”.

2. Ngarkohen subjektet e kësaj rregulloreje me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikës 1, shkronja “e” e këtij vendimi, e cila hyn në fuqi më 1 maj 2025.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 11, datë 5.2.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “MBI
TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET
DHE SHËRBIMET BANKARE E
FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 53, pika 4, nenit 55, pika 1, shkronja “e”, nenit 56, pika 2, dhe neneve 69, 124 dhe 125 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 59, datë 29.8.2008, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Përmbajtja e nenit 2 ndryshon si më poshtë:

“Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat, degët e bankave të huaja, subjektet financiare jobanka, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike (më poshtë për thjeshtësi do t’i referohemi me termin “banka”), të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.”;

b) Në nenin 4, pika 2, pas shkronjës “f”, shtohen shkronjat “g”, “h”, “i”, “j” dhe “k” përkatësisht me përmbajtjen e mëposhtme:

“g) “publicitet/reklamë në media elektronike” – nënkupton publicitetin/reklamën në programet e radios dhe televizionit, si dhe në programet sipas kërkesës (on-demand), që janë të disponueshme nëpërmjet rrjeteve elektronike të komunikimit, në këmbim të pagesës;



h) “publicitet/reklamë në media të shkruar (të shtypur)” – nënkupton publicitetin/reklamën në shtypin e ditës, në revista dhe në forma të tjera të shtypura të informimit publik, si dhe në botimet e tyre në formë digjitale, të cilat janë identike me botimin e shtypur dhe janë të disponueshme për publikun sipas kërkesës, online;

i. “publicitet/reklamë në ambiente të jashtme” – nënkupton publicitetin/reklamën nëpërmjet mjeteve të përshtatshme për përcjelljen e një mesazhi promociional për publikun, të vendosur në ambiente të jashtme dhe në dispozicion për publikun dhe/ose për një numër të pacaktuar marrësish (panel reklamash, stendë, afishe, ekran, tabela ndriçuese etj.);

j. “publicitet/reklamë në ambiente të brendshme” – nënkupton përcjelljen e mesazhit reklamues nëpërmjet posterave, afisheve, paneleve, broshurave, fletushkave, fletëpalosjeve etj., të cilat janë instaluar dhe/ose shpërndarë në ambientet e brendshme të biznesit të bankës dhe partnerëve të saj të biznesit (p.sh. institucionet financiare të lidhura, tregtarët etj.) dhe/ose në hapësira të tjera të brendshme të aksesueshme nga publiku (p.sh. në qendra tregtare, aeroporte, stacione të autobusëve, mjete transporti publik etj.);

k. “publicitet/reklamë online” – nënkupton publicitetin/reklamën në faqe interneti, në rrjete sociale, aplikacione ose nëpërmjet formave të tjera të komunikimit online.”;

c) Neni 10 “Marketingu”, shfuqizohet;

d) Pas nenit 12, shtohet kreu III “Marketingu dhe publiciteti i produkteve e shërbimeve” që përmban nenet 12/1, 12/2, 12/3, 12/4, 12/5, 12/6 dhe 12/7, me përmbajtjen e mëposhtme:

“KREU III MARKETINGU DHE PUBLICITETI I PRODUKTEVE E SHËRBIMEVE PËR KONSUMATORËT

Neni 12/1

Përmbajtja e publicitetit/reklamës apo materialeve promociionale

1. Banka siguron që çdo komunikim në formën e publicitetit/reklamës apo materialeve promociionale në lidhje me produktet apo shërbimet që do të ofrojë:

- a) të jetë i qartë, i saktë, i vërtetë, i përditësuar;
- b) të jetë në gjuhën shqipe dhe i shprehur në një gjuhë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, për të mos lejuar keqinterpretimet;
- c) të sqarojë kushtet kryesore të ofrimit të produkteve dhe/ose shërbimeve, si dhe të drejtat/përfitimet, detyrimet apo rreziqet që lidhen me këto produkte ose shërbime;

d) të mos përfshijë informacion të pasaktë, që çon në përfundime të gabuara, apo që zmadhon së tepërmi, ose përpigjet të fshehtë veçori të produkteve dhe shërbimeve të ofruara.

2. Publiciteti/reklama apo materialet promociionale duhet të përmbajnë të paktën informacionin standard të parashikuar në këtë krye, sipas llojit të produktit apo shërbimit që do të ofrohet.

3. Në rastin e promovimit të karakteristikave preferenciale ose përjashtimore të produkteve/shërbimeve (për shembull, normat e interesit ose segmenti i klientelës), banka në të njëjtin publicitet/reklamë informon dhe mbi kushtet e veçanta që duhen plotësuar për ta përfituar këtë produkt/shërbim.

4. Informacioni i përdorur për promovimin e produkteve dhe të shërbimeve bazohet në të dhëna të sakta, të verifikueshme, të hollësishme, në përputhje me parimin e mirëbesimit dhe të praktikave më të mira të konkurrencës së ndershme dhe etikës profesionale, me qëllim që t’i komunikojë publikut një informacion objektiv, të mjaftueshëm e të paanshëm.

Neni 12/2

Format/kanalet e publicitetit dhe reklamimit të materialeve promociionale

1. Banka mund të bëjë publicitetin apo reklamimin e materialeve promociionale, por pa u kufizuar, në një ose disa nga format e mëposhtme:

- a) broshura;
- b) publicitet në shtypin e ditës, revista, radio, televizione, rrjete sociale ose faqe interneti;
- c) materiale promociionale të dërguara me postë të zakonshme ose elektronike, faks ose mjete të tjera;
- d) telemarketing, i cili përfshin përdorimin e një ofruesi të specializuar të shërbimit telemarketing, në bazë të një kontrate të lidhur me bankën;

e) materiale apo mjete të tjera promociionale, që mund të lexohen, shihen apo dorëzohen/dërgohen te publiku.

2. Banka siguron që materialet promociionale në formë të shkruar, të paraqesin një mesazh të lexueshëm dhe të kuptueshëm për publikun.

3. Madhësia e tekstit të mesazhit promociional të transmetuar nëpërmjet medias elektronike ose online, si dhe të mesazhit promociional të publikuar në median e shkruar dhe të shpërndarë nëpërmjet publicitetit/reklamës në ambiente të brendshme ose të jashtme, duhet të jetë e tillë që të lexohet lehtësisht nga publiku, duke respektuar kërkesat e parashikuara në aneksin 3 të kësaj rregulloreje.



4. Banka siguron që për format e publicitetit nëpërmjet medias elektronike, mesazhi i materialit promocional duhet të zgjatë për një kohë të mjaftueshme, për të krijuar mundësinë që publiku ta lexojë dhe/ose dëgjojë përmbajtjen e mesazhit.

5. Banka siguron që për format e publicitetit online, mesazhi i materialit promocional nëpërmjet imazheve/figurave me ose pa zë, duhet të zgjatë për një kohë të mjaftueshme, për të krijuar mundësinë që publiku ta lexojë dhe/ose dëgjojë përmbajtjen e mesazhit.

Neni 12/3

Informacioni standard në publicitetin/reklamat ose materialet promocionale për kreditë konsumatore

1. Banka, në publicitetin/reklamat ose materialet promocionale për kreditë konsumatore, përfshin një paralajmërim të qartë dhe të dukshëm, për të ndërgjegjësuar konsumatorin se huamarrja kushton para, duke përdorur formulimin “Kujdes! Huamarrja e parave kushton para” ose një formulim të ngjashëm me të.

2. Banka, në çdo publicitet/reklamë ose material promocional për kreditë konsumatore, që tregon një normë interesi ose çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, duhet të përfshijë informacionin standard të përcaktuar në këtë nen.

3. Kërkesat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, nuk do të zbatohen në rastet kur banka tregon apo paraqet në publicitet/reklamë ose material promocional, normën efektive të interesit të përlogaritur sipas kërkesave rregullative të Bankës së Shqipërisë, e cila nuk tregon apo paraqet një normë interesi ose çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, në kuptim të pikës 2 të këtij neni.

4. Informacioni standard i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm ose qartësisht i dëgjueshëm, sipas rastit, dhe të përshtatet me kufizimet teknike të mjetit të përdorur për reklamim, si dhe duhet të specifikojë, në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme të gjitha elementet e mëposhtme:

a) emrin e plotë të bankës, faqen zyrtare të internetit dhe numrin e telefonit;

b) normën e interesit të kredisë, fikse ose variabël ose të dyja, së bashku me të dhënat mbi çdo komision apo tarifë të përfshirë në koston totale të kredisë për konsumatorin;

c) vlerën totale të kredisë, siç përcaktohet në nenin 5, pika 2, shkronja “m” të rregullores “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”;

d) normën efektive të interesit, e cila duhet të përfshihet në publicitet/reklamë në mënyrë aq të dukshme sa edhe

norma e interesit të kredisë;

e) ku është e aplikueshme, kohëzgjatjen e kontratës së kredisë;

f) në rastin e një kredie në formën e një pagese të shtyrë, për një mall ose shërbim të veçantë, çmimin në para dhe shumën e çdo paradhënieje;

g) ku është e aplikueshme, shumën totale të pagueshme nga konsumatori dhe vlerën e kësteve, të përshtatur sipas vlerës totale të kredisë të parashikuar në shkronjën “i” të kësaj pike.

5. Banka, vetëm në rastet e publicitetit online që ka një përmbajtje të formës së shkurtuar, mund të mos përfshijë në mesazhin promocional disa informacione të nevojshme të parashikuara në pikat 4 dhe 7 të këtij neni, por mesazhi duhet të përmbajë një lidhje (link) direkte me faqen e internetit të bankës, që përmban informacionin e papërfshirë në mesazh. Të dhënat për faqen e internetit të bankës duhet të jenë të dukshme, në mesazhin promocional.

6. Në raste specifike dhe të justifikuara kur mjeti/kanali i përdorur për të reklamuar informacionin standard të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, nuk lejon që informacioni të shfaqet vizualisht në mënyrë të dukshme dhe të qartë, shkronjat “f” dhe “g” të asaj pike nuk do të zbatohen. Në rastin e një mjeti/kanali elektronik të përdorur për të reklamuar informacionin standard, konsumatori duhet të jetë në gjendje të aksesojë informacionin e parashikuar në shkronjat “f” dhe “g” të pikës 4 të këtij neni, nëpërmjet klikimit, lëvizjes (scrolling) ose rrëshqitjes (swiping).

7. Në rastet kur lidhja e një kontrate për një shërbim ndihmës të lidhur me kontratën e kredisë është e detyrueshme për të marrë kredinë ose për ta përfutur atë sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, dhe kostoja e atij shërbimi nuk mund të përcaktohet paraprakisht, informacioni standard i referuar në pikën 4 të këtij neni, duhet të specifikojë në mënyrë të qartë, koncize dhe të dukshme detyrimin për ta lidhur atë kontratë.

Neni 12/4

Informacioni standard në publicitetin/reklamat ose materialet promocionale për kreditë hipotekare

1. Banka, në çdo publicitet/reklamë ose material promocional për kreditë hipotekare, që tregon një normë interesi ose çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, duhet të përfshijë informacionin standard të përcaktuar në këtë nen.

2. Kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk do të zbatohen në rastet kur banka



tregon apo paraqet në *publicitet/reklamë* ose *material promocional*, normën efektive të interesit të përlogaritur sipas kërkesave rregullative të Bankës së Shqipërisë, e cila nuk tregon apo paraqet një normë interesi ose çdo shifër apo informacion që lidhet me çdo kosto të kredisë për konsumatorin, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

3. Informacioni standard i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm ose qartësisht i dëgjueshëm, sipas rastit, dhe të përshtatet me kufizimet teknike të mjetit të përdorur për reklamim, si dhe duhet të specifikojë, në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme të gjitha elementet e mëposhtme:

a) emrin e plotë të bankës, faqen zyrtare të internetit dhe numrin e telefonit;

b) normën e interesit të kredisë, fikse ose variabël ose të dyja, së bashku me të dhënat mbi çdo komision apo tarifë të përfshirë në koston totale të kredisë për kredimarrësin;

c) vlerën totale të kredisë, siç përcaktohet në nenin 5, pika 2, shkronja “m” të rregullores “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”;

d) normën efektive të interesit, e cila duhet të përfshihet në *publicitet/reklamë* në mënyrë aq të dukshme sa edhe norma e interesit të kredisë;

e) kohëzgjatjen e kontratës së kredisë;

f) shumën totale të pagueshme nga konsumatori;

g) vlerën e kësteve, të përshtatur sipas vlerës totale të kredisë të parashikuar në shkronjën “c” të kësaj pike;

h) një paralajmërim në lidhje me pasojat e mundshme të luhatjes së kursit të këmbimit, në shumën e pagueshme nga kredimarrësi (nëse është e aplikueshme);

i) garancitë/siguritë e nevojshme, në formën e një hipoteke mbi një pasuri ose të një garancie tjetër.

4. Banka, vetëm në rastet e *publicitetit online* që ka një përmbajtje të formës së shkurtuar, mund të mos përfshijë në mesazhin promocional disa informacione të nevojshme të parashikuara në pikat 3 dhe 5 të këtij neni, por mesazhi duhet të përmbajë një lidhje (link) direkte me faqen e internetit të bankës, që përmban informacionin e papërfshirë në mesazh. Të dhënat për faqen e internetit të bankës duhet të jenë të dukshme, në mesazhin promocional.

5. Në rastet kur lidhja e një kontrate për një shërbim ndihmës, në veçanti një kontrate sigurimi, është e detyrueshme për të marrë kredinë ose për ta përfutur atë sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, dhe kostoja e atij shërbimi nuk mund të përcaktohet paraprakisht, detyrimi për ta lidhur atë kontratë duhet të specifikohet në mënyrë të qartë, koncize dhe të dukshme, së bashku me normën efektive të interesit.

Neni 12/5

Informacioni standard në publicitetin/reklamat ose materialet promocionale për depozitat

1. Banka, në *publicitetin/reklamat* ose *materialet promocionale* për depozitat, përfshin informacionin standard, i cili duhet të jetë lehtësisht i lexueshëm ose qartësisht i dëgjueshëm, sipas rastit, dhe të përshtatet me kufizimet teknike të mjetit të përdorur për reklamim, si dhe duhet të specifikojë, në mënyrë të qartë, të saktë dhe të dukshme të gjitha elementet e mëposhtme:

a) emrin e plotë të bankës, faqen zyrtare të internetit dhe numrin e telefonit;

b) normën vjetore të interesit të depozitës;

c) normën e interesit mesatar ose normat përkatëse, nëse aplikohet më shumë se një normë interesi gjatë afatit të depozitës;

d) afatin e depozitës;

e) penalitetet e aplikueshme në rastin e zgjidhjes para afatit të përfundimit të kontratës.

2. Banka, vetëm në rastet e *publicitetit online* që ka një përmbajtje të formës së shkurtuar, mund të mos përfshijë në mesazhin promocional disa informacione të nevojshme të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, por mesazhi duhet të përmbajë një lidhje (link) direkte me faqen e internetit të bankës, që përmban informacionin e papërfshirë në mesazh. Të dhënat për faqen e internetit të bankës duhet të jenë të dukshme, në mesazhin promocional.

Neni 12/6

Ndalimi/ndërprerja e publicitetit/reklamës apo materialeve promocionale

1. Departamenti i Mbikëqyrjes urdhëron bankën të ndalojë/ndërpresë ose të korrigjojë *publicitetin/reklamën* apo *materialet promocionale*, nëse konstaton se përmbajtja e tyre bie në kundërshtim me kërkesat e këtij kreu.

2. Bankat nuk lejohen të reklamojnë produkte apo shërbime që:

a) përmbajnë vlerësime ose parashikime në lidhje me ecurinë e ardhshme të bankës;

b) përmbajnë krahasime ndërmjet bankave të ndryshme që ofrojnë të njëjtat produkte apo shërbime, që vënë në disavantazh banka të tjera;

c) përmbajnë shprehje si “rezultat i garantuar”, “banka më e mirë”, “kosto më e ulët në treg”, “kosto zero”, “tarifa zero”, “komisione zero”, “interes zero”, “pa interes”, “më e lartë/më e ulët/më e mira në treg”, “ne ju rimbursojmë”, “ne paguajmë për ju”, “ofertë”, “dburatë”, “miratim i garantuar” etj., ose çdo formulim tjetër që mund



të krijojë përshtypjen për fitime/ rezultate të sigurta apo për kosto të ulëta.

3. Përjashtimisht nga sa parashikohet në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij neni, banka mund të përdorë në publicitet/reklamë apo materialet promocionale, shprehjet e mëposhtme, vetëm nëse plotësohen kushtet përkatëse, si vijon:

a) “pa interes”, “interes zero”, ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur nuk paguhet interes nga konsumatori dhe nëse të gjitha kushtet e kontratës së kredisë ose shërbimeve të tjera financiare dhe të gjitha tarifat dhe komisionet (ku në këtë rast norma efektive e interesit nuk është 0%), të paraqiten në mënyrë të dukshme në publicitet/reklamë;

b) “kosto zero”, “tarifa zero”, “komisione zero” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur nuk paguhet interesa, komisione ose tarifa të tjera nga konsumatori dhe nëse marrja e një kredie ose shërbimi tjetër financiar, nuk është e kushtëzuar nga lidhja e një marrëveshjeje tjetër ose që krijon tarifa, komisione ose detyrime të tjera për konsumatorin;

c) “miratim i garantuar” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur marrja e një kredie ose shërbimi tjetër financiar nuk është e kushtëzuar nga përmbushja e kërkesave të lidhura me aftësinë paguese ose kërkesave të tjera;

d) “ofertë”, “dhuratë” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur nuk ka kushte ose rrethana që kërkojnë që konsumatori të kompensojë ose të kthejë përfitimin që i është vënë në dispozicion, për shkak të lidhjes së marrëveshjes së kredisë ose të një shërbimi tjetër financiar;

e) “ne ju rimbursojmë” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur fondet e paguara nga konsumatori do të rimbursohen plotësisht nga banka;

f) “ne paguajmë për ju” ose shprehje të ngjashme, vetëm nëse banka përballon plotësisht kostot ose nëse banka përballon një pjesë të kostove, me kusht që pjesa përkatëse e mbuluar nga konsumatori të paraqitet në mënyrë të dukshme në publicitet/reklamë;

g) “kostoja më e ulët në treg”, “më e lartë/ më e ulët/ më e mira në treg”, “kushtet më të mira në treg” ose shprehje të ngjashme, vetëm në rastet kur paraqiten në mënyrë të dukshme në publicitet/reklamë, edhe kushtet e veçanta të kredisë apo shërbimit financiar që vërtetojnë apo që qëndrojnë në bazë të këtyre shprehjeve.

4. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, bankat nuk lejohen të reklamojnë produkte të kredisë konsumatore që:

a) inkurajojnë konsumatorët të kërkojnë kredi, duke sugjeruar se kredia do të përmirësonte gjendjen financiare të këtyre konsumatorëve;

b) specifikojnë se shumat e papaguara (tepricat) të kredisë kanë pak ose aspak ndikim në vlerësimin e një aplikimi të ri për kredi;

c) sugjerojnë në mënyrë të rreme se kredia çon në një rritje të burimeve financiare, përbën një zëvendësues për kursimet ose mund të rrisë standardet e jetesës së një konsumatori;

d) theksojnë lehtësinë ose shpejtësinë me të cilën mund të merret kredia;

e) deklarojnë se një zbritje është e kushtëzuar me marrjen e kredisë;

f) ofrojnë periudha “grace” më shumë se tre muaj për shlyerjen e kësteve të kredisë.

Neni 12/7

Ruajtja e publicitetit/reklamës apo materialeve promocionale

1. Banka ruan për 5 vite nga data e publikimit, një kopje të publicitetit/reklamës apo materialeve promocionale.

2. Banka ruan të dhënat për të gjitha publicitetet/reklamën apo materialet promocionale, duke përfshirë:

a) një dokument në format elektronik;

b) datën e miratimit të publicitetit/reklamës apo materialit promocional për publikim;

c) kanalën/vendin ku është publikuar publiciteti/reklama apo materiali promocional.

3. Të dhënat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni i vihen në dispozicion Bankës së Shqipërisë me kërkesën e saj, ose gjatë inspektimeve në vend.”;

e) Kreu III “Dispozita përfundimtare” rinumërohet si kreu IV “Dispozita përfundimtare”;

f) Pas aneksit nr. 2, shtohet aneksi nr. 3, me përmbajtjen sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen subjektet e rregullores për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 maj 2025 dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**KRYETAR
Gent Sejko**



ANEKS

ANEKS NR. 3

**MADHËSIA MINIMALE E SHKRIMIT
PËR TË PËRDORUR NË MESAZHIN E
PUBLICITETIT/REKLAMËS APO
MATERIALIT PROMOCIONAL**

Publiciteti/reklama e paraqitur në:	Madhësia minimale e shkrimit
<i>Media elektronike</i>	<i>12 pt</i>
<i>Media të shëruar dhe online</i>	<i>9 pt</i>
<i>Ambiente të brendshme në formën e broshurave, fletushkave, fletëpalosjeve etj.</i>	<i>11 pt</i>
<i>Ambiente të brendshme në formën e posterave, afisheve, paneleve etj.</i>	<i>25 pt</i>
<i>Ambiente të jashtme, me madhësi mesatare, në formën e paneleve të reklamave, standave, afisheve, ekraneve etj. (për shembull, llojet Opi/Mupi dhe Master)</i>	<i>85 pt</i>
<i>Ambiente të jashtme, në formën e paneleve të reklamave, standave, afisheve, ekraneve etj., në format të madh, me përmasa të tilla si 4x3 m, 5x2.4 m, 8x3 m ose 10x5 m</i>	<i>Madhësia e shkrimit duhet të zmadhohet në mënyrë të tillë që të ruhet proporcioni që rezultojn nga madhësia minimale e shkrimit e përvaktuar për kategoritë e mësipërme.</i>

VENDIM

Nr. 3, datë 3.2.2025

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT
TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, nenin 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, të ndryshuar, me urdhrin nr. 234, datë 25.10.2024, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, “Për

krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 3, datë 3.2.2025, si më poshtë.

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, Fondi Kosova. Fashikull nr. 1131 në ngarkim të A.A., me 106 (njëqind e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1965–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë. Dosje formulare nr. 160, në ngarkim të V.K., me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1949–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

3. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e IV. Dosje përpunimi nr. 6429 dhe fashikull personal për të dënuar, në ngarkim të P.A., me 422 (katërqind e njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

4. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Berat. Dosje formulare nr. 1381, në ngarkim të E.K., me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1945–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

5. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë. Dosje përpunimi nr. 335, në ngarkim të S.H., me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1951–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

6. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Ersekë. Dosje përpunimi nr. 1134 dhe fashikull personal për të dënuar në ngarkim të E. D., me 122 (njëqind e njëzet e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1958–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

7. Arkiva e Autoritetit, Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë. Dosje formulare nr. 3395 në ngarkim të B.T., me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1978–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

8. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisur. Fashikull nr. 1635 dhe dosje formulare nr. 10882 në ngarkim të R.Sh., në total me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

9. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë. Dosje përpunimi nr. 11923 në ngarkim të H.F., me 119 (njëqind e nëntëmbëdhjetë)



fletë. Dosja daton në vitet 1969–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

10. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria II. Rregullore e evidencës operative nr. 1-1 datë 1986, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Rregullorja daton në vitin 1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

11. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria II. Rregullore e evidencës operative nr. 1-1 datë 1986, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Rregullorja daton në vitin 1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

12. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria II. Rregullore e evidencës agjenturale operative nr. 1-1 datë 9.1.1986, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Rregullorja daton në vitin 1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

13. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 6. Plane masash agjentalo-operative në drejtim të delegacionit italian, që do të tërheqë eshtrat e ushtarëve italianë të vrarë në Shqipëri, me 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

14. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 2. Evidenca e zb. amerikan: Historiku i zbulimit amerikan; relacion mbi të implikuarit në vitin 1946–1947, si dhe lidhje e grupeve tekniko-intelektualëve dhe deputetëve (lista e anëtarëve të këtij grupi); lista e personave që dyshohen spiunë; ekstrakte, materiale për ish-misionarët e UNRRA-së, gjatë vitit 1945–1947 në Shqipëri, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

15. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 3. Evidenca e zb. francez: Lista e personave që dalin si lidhje të legatës franceze në Tiranë për rrethin e Gjirokastrës; lista e kontingjentit të zb. francez për rrethin Gjirokastër; raporte, informacione, relacione mbi lidhjet e personave nga rrethi Gjirokastrës me legatën franceze gjatë viteve 1956, 1958, 1960, 1961, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

16. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 5. Historiku i zbulimit italian për rrethin e Gjirokastrës; lista e personave që përbëjnë kontingjentin e SIMIT; organizimi i policisë (ish-kuesturës italiane), me 21 (njëzet e një)

fletë. Dosja daton në vitet 1952–1962. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

17. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 4. Evidenca e zb. italian: historiku, organizimi i kuesturës, fashos të qarkut Gjirokastër nga Korriku 1942; raport informativ, me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1942–1963. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

18. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 7. Evidenca e zb. turk: relacione, statistika, lista e të arratisurve në Turqi nga rrethi i Gjirokastrës, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1959–1963. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

19. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 7. Evidenca e zb. gjerman: Historiku i zbulimit gjerman qarku Gjirokastër; lista e të internuarve nga trupat gjermanë në kampet e Gjermanisë të rrethit Gjirokastër; lista e personave që kanë bashkëpunuar me autoritetet e ushtrisë gjermane gjatë okupacionit gjerman 1942–1944; lista e të arratisurve nga rrethi i Gjirokastrës që ndodhen në Gjermaninë Perëndimore; lista tregtarëve të qytetit të Gjirokastrës që kanë pasur tregti me Gjermaninë; karakteristikë, biografi, relacione, me 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1956–1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

20. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 9. Evidenca e zb. jugosllav: Lista e lidhjeve të personave jugosllavë; lista e kontingjenteve të zbulimit jugosllav; plan masash agjenturale-operative, biografi, relacione mbi punën e bërë dhe masat e mara për zbulimin jugosllav në rrethin e Gjirokastrës; lista dhe statistika e emigrantëve jugosllavë që jetojnë në rrethin e Gjirokastrës, me 23 (njëzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1957–1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

21. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 1. Sesioni I i Sigurimit 1969 me temë: “26-vjet luftë dhe fitore mbi armikun e organeve të sigurimit të shtetit në rrethin e Gjirokastrës”, kumtesa, diskutime, me 40 (dyzet) fletë. Dosja daton në vitet 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

22. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 1, dosje 2. Sesioni II i Sigurimit, kumtesa “Lufta e organeve të sigurimit të rrethit



Gjirokastrë për zbulimin dhe shpartallimin e agjenturës greke”, me 102 (njëqind e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

23. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 1, dosje 4. Fashikulli i sesioneve shkencore të anës “Sigurimit Shtetit”, dorëshkrime, procesverbale protokoll, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

24. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 1, dosje 10. Evidenca e zb. anglez: Historikë të zbulimit anglez; lista e kontingjenteve të zbulimit anglez në rrethin e Gjirokastrës; deklarata të riatdhesuarve dhe përfaqësuesve të OKB në Nju Jork, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1955–1971. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

25. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 1, dosje 3. Referat: “Tërheqja në bashkëpunim e agjenturës me material shtrëngues dhe rrugët për gjetjen e saj”, referate, kumtesa, mbajtur në sesionin III shkencor të sigurimit, me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1972. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

26. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 1, dosje 5. Shkresa përcjellëse të korrespondencës së Degës Punëve të Brendshme Gjirokastrë me Drejtorinë III për verifikim, studim dosje të arratisurve, me 3 (tre) fletë. Dosja daton në vitet 1985–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

27. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 33. Dosje drejtimi për sektorin ekonomik të Kulturës: fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse në sektorin ekonomik të kulturës; fashikulli II mbi agjenturën në sektorin ekonomik të kulturës, me 2 volume, në total me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

28. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 66. Fashikull kërkimi, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

29. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 73. Dosje drejtimi për zbulimin e veprimtarisë keqbërëse në drejtim të krimit kundra personit: Fashikulli I mbi agjenturën, fashikulli II mbi veprimtarinë keqbërëse në drejtim

të vrasjes kundra personit, me 2 volume, në total me 114 (njëqind e katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

30. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 74. Dosje drejtimi për zbulimin e veprimtarisë keqbërëse në drejtim të akteve të rrugaçërisë e vagabondazhit: Fashikulli I mbi agjenturën, fashikulli II mbi veprimtarinë keqbërëse në drejtim të akteve të rrugaçërisë e vagabondazhit, me 2 volume, në total me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1964–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

31. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 75. Dosje drejtimi për zbulimin e veprimtarisë keqbërëse në drejtim të vjedhjeve të pasurisë socialiste me thyeje nga jashtë: Fashikulli I mbi agjenturën, fashikulli II mbi veprimtarinë keqbërëse në drejtim të vjedhjeve të pasurisë socialiste me thyerje nga jashtë, me 2 volume, në total me 106 (njëqind e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

32. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 76. Dosje drejtimi për zbulimin e veprimtarisë keqbërëse në drejtim të vjedhjeve të pasurisë qytetare: Fashikulli I mbi agjenturën, fashikulli II mbi veprimtarinë keqbërëse në drejtim të vjedhjeve të pasurisë qytetare, me 2 volume, në total me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

33. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 145. Dosje drejtimi për Lëndët Narkotike “Drogat”: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse me lëndët narkotike, fashikulli II mbi agjenturën, me 2 volume, në total me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

34. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 146. Dosje drejtimi për Krime të Tjera: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse për krime të tjera, fashikulli II mbi agjenturën, me 2 volume, në total me 28 (njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

35. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 2, dosje 189. Dosje drejtimi për



sektorin ekonomik të Arsimit: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse në sektorin ekonomik, fashikulli II mbi agjiturën në sektorin ekonomik të arsimit, me 2 volume, në total me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

36. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 190. Dosje drejtimi për sektorin ekonomik të Shëndetësisë: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse për MES-in, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

37. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 191. Dosje drejtimi për Industrinë e Rëndë: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse në Industrinë e Rëndë, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

38. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 192. Dosje drejtimi për sektorin ekonomik të Ndërtimit: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 14 (katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

39. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 193. Dosje drejtimi për sektorin ekonomik të Industrisë së Lehtë e Ushqimore: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

40. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 194. Dosje drejtimi për sektorët ekonomik të Tregtisë: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

41. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 195. Dosje drejtimi për Ndërlidhje-Komunikacion: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse në ndërlidhje parkun automobilistik, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 14 (katërmëdhjetë) fletë. Dosja

daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

42. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 196. Dosje drejtimi për Bujqësinë: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse në bujqësi, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

43. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 216. Dosje drejtimi për sektorët ekonomik të Komunales: Fashikulli I mbi veprimtarinë keqbërëse, fashikulli II mbi agjiturën, me 2 volume, në total me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

44. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 217. Dosje e Objektit të Rëndësisë së Veçantë (Ndërmarrja e N.T.A.N-it): me 2 volume, në total me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

45. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 218. Dosje e Objektit të Rëndësisë së Veçantë (Ndërmarrja e N.T.SH-së): me 2 volume, në total me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

46. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 219. Dosje e Objektit të Rëndësisë së Veçantë (Ndërmarrja e Grumbullimit): me 2 volume, në total me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

47. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 2, dosje 252. Dosje e drejtimit të Bankë-Financë: me 2 volume, në total me 14 (katërmëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

48. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 1, në ngarkim të Sh. B., me 35 (tridhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

49. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agjitoriale nr. 2, “Kordhoca”, vrasje për hakmarrje, në ngarkim të B.M., M.M., D.B., me 82 (tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.



50. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 3, për vrasje, në ngarkim të M.M., me 44 (dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

51. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 4, vrasje për hakmarrje, në ngarkim të B.M., me 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1970–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

52. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 8, tendencë vrasjeje, në ngarkim të B.B., H.B., Z.B., me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

53. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 8, në ngarkim të H.B., me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

54. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 9, në ngarkim të B.B., me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

55. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 10, në ngarkim të Z.B., me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

56. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 11, në ngarkim të M.M., 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1971–1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

57. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 18, për aborte, në ngarkim të N.F., me 33 (tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1974–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

58. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 48, në ngarkim të J.Z., me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

59. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje formulare nr. 1987, në ngarkim të S.M., me 26 (njëzet e gjashtë) fletë. Dosja

daton në vitet 1981–1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

60. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 3, për vjedhje xhepush dhe imoralitet, në ngarkim të T.Dh., V.Dh., me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

61. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 31, “Gracka”, për vjedhje me thyerje, në ngarkim të G.Xh., R.Xh., Sh.Sh., N.T., me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1984–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

62. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 51, për materialet e aktivitetit të përbashkët (grupi i K.B.), në ngarkim të J.V., F.K., K.Q., me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

63. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 69, “Gracka”, për luajtje bixhozi, në ngarkim të N.Zh., S.L., S.D., me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

64. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 88, “Korbi”, vjedhës të pasurisë socialiste, në ngarkim të N.R., K.K., A.M., me 38 (tridhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

65. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 188, “Vagabondi”, për vjedhje të pasurisë qytetare, në ngarkim të K.Z., S.V., K.Ll., R.Xh., me 45 (dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1980–1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

66. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 246, “Zinxhiri”, për përvetësim të pasurisë socialiste, në ngarkim të Xh.R., Xh.L., D.M., me 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

67. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastër, kutia 3, dosje agenturale nr. 247, “Merimanga”, për luajtje bixhozi, në ngarkim të N.K., V.P., Y.G., me 22 (njëzet e dy) fletë. Dosja



daton në vitet 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

68. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 3, dosje kërkimi me 2 volume me nr. 3 dhe nr. 244, për gjetjen e R.B., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

69. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 3, dosje kërkimi nr. 117, në ngarkim të E. M., me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

70. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Gjirokastrë, kutia 3, dosje kërkimi nr. 118, në ngarkim të V.V., me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

71. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Librazhd, kutia 1, dosar nr. 1, “Stërvitja Komplekse Shkumbini 1986”, me përmbajtje:

- Dosje pa numër me praktikën mësimore (urdhër, informacione, procesverbale etj.), me 90 (nëntëdhjetë) fletë.

- Dosje pa numër me praktikën mësimore (vendim, konkluzione, informacione, etj.), me 203 (dyqind e tre) fletë.

- Dosje nr. 7, datë 11.4. 1986, për telegramet e ardhura, me 2 (dy) fletë.

- Dosje nr. 8, datë 11.4.1986, për telegramet e dala, me 9 (nëntë) fletë.

- Fletore komplet bosh nr. 17, datë 3.4.1986, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë.

- Fletore komplet bosh nr. 18, datë 3.4.1986, me 48 (dyzet e tetë) fletë.

- Fletore komplet bosh nr. 18/1, datë 3.4.1986, me 40 (dyzet) fletë.

- Fletore shënimesh nr. 19, datë 3.4.1986, me 48 (dyzet e tetë) fletë, pjesërisht e plotësuar.

- Fletore mësimore nr. 21, datë 4.4.1986, për stërvitje, me 29 (njëzet e nëntë) fletë.

- Fletore komplet bosh nr. 22, datë 4.4.1986, me 32 (tridhjetë e dy) fletë.

- Fletore komplet bosh nr. 23, datë 4.4.1986, me 60 (gjashtëdhjetë) fletë.

- Regjistër mësimor nr. 25, datë 4.4.1986, i informacioneve me kod bisedimi, me 10 (dhjetë) fletë (vetëm 1 fletë e plotësuar).

- Regjistër mësimor nr. 26, datë 4.4.1986, i informacioneve të ardhura me kod bisedimi, me 10 (dhjetë) fletë, bosh.

- Regjistër mësimor nr. 27, datë 4.4.1986, i dorëzimit të informacionit me kod bisedimi, me 10 (dhjetë) fletë.

- Harta 7 (shtatë) copë.

- Bllok ditar nr. 31, datë 4.4.1986, me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë.

- Bllok ditar nr. 79, datë 13.10.1973, për agj-konservuar, me 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) fletë. pjesërisht e plotësuar

- Libër (fletore) dorëzimi për telegrame për grupin e informacionit, 30 (tridhjetë) fletë, vetëm 1 fletë e plotësuar.

- Fletore mësimore për stërvitje 2 copë, janë bosh.

Në total me 865 (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

72. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Librazhd, kutia 1, dosar nr. 2, “Stërvitja Komplekse Shebeniku 1980”, me përmbajtje:

- Dosje mësimore pa numër, me informacione dhe komunikata “Shebeniku 80”, me 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë,

- Dosje pa numër, situata mësimore “Shebeniku 80”, me 144 (njëqind e dyzet e katër) fletë.

- Dosje mësimore pa numër, me 87 (tetëdhjetë e shtatë) fletë.

- Regjistër mësimor sekretimi blloqe e fletore, me 5 (pesë) fletë.

- Libri/fletore dorëzimit (mësimore) për shpërndarjen e postës mod-6, me 43 (dyzet e tre) fletë.

- Ditari i vrojtimit, me 46 (dyzet e gjashtë) fletë (pjesërisht i plotësuar).

- Harta 8 (tetë) copë.

Në total me 421 (katërqind e njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

73. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Librazhd, kutia 2, dosje drejtimi nr. 3, për ndjekjen e veprimtarisë armiqësore të armikut përballë, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1966–1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

74. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Librazhd, kutia 2, dosje drejtimi nr. 4, për ndjekjen e veprimtarisë armiqësore të armikut përballë, me 257



(dyqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1981–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

75. Arkivi i Autoritetit, Fondi 141, DPB Librazhd, kutia 2, dosje drejtimi nr. 6, fashikulli I i veprimtarisë armiqësore në sektorin Industri-Miniera, fashikulli II mbi agjunkturën, me 2 volume, në total me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

